

KONTRATË
SHIT – BLERJE KUOTASH

Sot, më datë 09 / 02 /2018, Shitësi dhe Blerësi, kanë rënë dakort për redaktimin e kësaj kontrate Shit-Blerje Kuotash me termat si më poshtë vijon:

SHITËSI: Shoqëria tregtare “**Albanian General Electricity**” Sh.a., subjekt i së drejtës shqiptare, regjistruar me numër identifikimi NIPT L41706021V, përfaqësuar nga Aksioneri i vetëm i saj Z. Besar LLAPASHTICA, shtetas shqiptar, i lindur në Fier, më 27.03.1990 dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. 032266246, **aksioner i vetëm i shoqërisë**, ortak në Shoqërine “AGE Sunpower” Shpk., dhe zoterues i 31% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise.

BLERËSI: Shoqëria Tregtare “**A.E.DISTRIBUTION**” Sh.p.k., subjekt i së drejtës shqiptare, regjistruar me numër identifikimi NIPT K21915002R, përfaqësuar nga përfaqësuesi i shoqërisë Z. Gerian KUKA, shtetas shqiptar, lindur në Tirane, më 23/03/1974, banues në Tiranë, Rruga “Dervish Hima”, Pallati 4 Edil Alit, Ap. 8D, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. SR8030240, **ortak i vetëm i shoqërisë**, Ortak në Shoqërine “AGE Sunpower” Shpk., dhe zoterues i 20 % të kuotave të saj.

OBJEKTI: Shitja e 30 % të kuotave të Shoqërisë “Albanian General Electricity” Sh.a., që kjo shoqëri zoteron në Shoqërine “AGE Sunpower” Shpk., me cilësinë e shitësit dhe blerja e tyre nga Shoqëria “A.E.DISTRIBUTION” Sh.p.k në masën 30% me cilësinë e blerësit.

PËRMBAJTA E KONTRATËS

Shoqëria Tregtare “AGE Sunpower”Sh.p.k. e cila është e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Tiranë me nr. NIPTI L73015401Q dhe ka Selinë në adresën : Njësia Njësia Administrative Topoje, Fshati Gryke, Pasaia me Nr. 55, Zona Kadastrale 2308, Shqipëri. Shoqëria ka një kapital themeltar të regjistruar prej 10,000 Lekë si më poshtë vijon:

- “Albanian General Electricity” Sh.a zotëron 31 % të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë “AGE Sunpower” Sh.p.k.

Me vendimin e datës 09 / 01 / 2018 të Asamblesë së Aksionerit të Vetëm të Shoqërisë, është vendosur shitja e kuotave në masën 30% të tyre nga ana e ortakut të shoqërisë "Albanian General Electricity" Sha., përkatësisht në masën 30% dhe blerja nga ana e Shoqërisë "A.E.DISTRIBUTION" Sh.p.k., në masën 30%.

Shitja në masën prej 30% të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë "Albanian General Electricity" Sh.a., sjell humbjen e të drejtës së pronësisë të 30% të kuotave të kapitalit themeltar të kësaj shoqërie në masën 30% të kuotave të kapitalit themeltar në Shoqërinë "AGESunpower", si pasojë e këtij transaksioni shitjeje, shprehur kjo në vendimin e Aksionerit të Vetëm, datë 09 / 01 / 2018.

Shitësi "Albanian General Electricity" Sha., është plotësisht dakord të shesi me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë 30% të kuotave që ai zotëron në shoqërinë "AGE Sunpower" Sh.p.k. Kjo shitje kuotash, sipas kësaj kontrate do të bëhet në favor të Blerësit Shoqërisë "A.E.DISTRIBUTION" Sh.p.k., e cila përfiton zotërimin e 30% të kuotave me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lindin ka kjo kontrate shitjeje.

Blerësi Shoqëria "A.E.DISTRIBUTION" Sh.p.k., është plotësisht dakord që të blejë me vullnetin e saj të lirë dhe të plotë, masën prej 30% të kuotave të zotëruara nga shitësi në kapitalin themeltar të Shoqërisë Tregtare "AGE Sunpower" Sh.p.k.

MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE

Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe kryerjen e pageses së çmimit të kësaj kontrate, shitësi, ortakut Shoqëria "Albanian General Electricity" Sh.a., humbet pronësinë përkatësisht në masën 30%, të kuotave të zotëruara prej tij në kapitalin themeltar të shoqërisë "AGE Sunpower" Sh.p.k., duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi pjesën e shitur në masën 30% të kuotave të shoqërisë. Ndërsa Blerësi Shoqëria "AE DISTRIBUTION" Sh.p.k., bëhet pronare përkatësisht në masën prej 30% të kuotave të shitura, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që mbart blerja e këtyre kuotave.

Shoqëria Tregtare "AGE Sunpower" Sh.p.k., pas realizimit të këtij operacioni shit-blerjeje kuotash, sipas kësaj kontrate, do të ketë si ortakë të saj me pjesëmarrje në kapitalin themeltar ortakët si më poshtë:

- Shoqëria "Seman Sunpower" Sh.p.k., zotëron 49% të kuotave në kapitalin themeltar të Shoqërisë "AGE Sunpower" Sh.p.k.



- Shoqëria tregtare “AE DISTRIBUTION” Sh.pk., zotëron 50% të kuotave në kapitalin themeltar të Shoqërisë “AGE Sunpower” Sh.p.k.
- Shoqëria tregtare “Albanian General Electricity” Sh.a, zotëron 1% të kuotave në kapitalin themeltar të Shoqërisë “AGE Sunpower” Sh.p.k.

ÇMIMI I SHITJES SË KUOTAVE

Si çmim i këtij transaksioni shit – blerje kuotash të shoqërisë “AGE Sunpower” Sh.p.k., do të jetë shuma prej 1,200,000 (njemilion e dyqind mijë) lekë.

Sipas këtij përcaktimi, Blerësi Shoqëria “AE DISTRIBUTION” Sh.p.k., do të paguajë në favor të Shitësit “Albanian General Electricity” Sha., shumën në total prej 1,200,000 (njemilion e dyqind mijë) lekë, shumë e cila do të paguhet sot në rrugë bankare. Mbas kryerjes së pageses nga ana e Blerësit, Shitësi nuk do të ketë sot dhe në të ardhmen pretendime për këtë shumë apo për çdo shumë tjetër.

DISPOZITA TË FUNDIT

Kontrata hartohet në 5 (pesë) kopje të njëjta në gjuhën shqipe nga të cilat një e mbajnë palët, një kopje depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe një kopje depozitohet në aktet e shoqërisë.

Pas përpilimit të kësaj kontrate, palët me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë e pranuan dhe e nënshkrojnë rregullisht. Kontrata hartohet në gjuhën shqipe.

PALËT

SHITËSI

“Albanian General Electricity” Sha.

Perfaqesuar nga
Besar Llapashtica

Besar Llapashtica



BLERËSI

“AE DISTRIBUTION” Shpk.

Perfaqesuar nga

Gerian KUKA

NIPF: K21915002R

TIRANE ALBANIA

JEP PËLQIMIN

Shoqëria “Seman Sunpower” Shpk

Perfaqesuar nga
Sadik Llapashtica

